



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 134/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me Nr.REF-87046-02-15-2021, me objekt “*Blerje lëndësh djegëse për ngrohje (Pellet)*”, me fond limit 7 920 000 (shtatë milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh.

Ankimues: “Nafire Molloholli” PF
Lagjja Partizani, Rruga Janaq Kilica, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh
Lagjja Sporti

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoj relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operator ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “Kërkesë për propozim”, Nr.REF-87046-02-15-2021, me objekt “*Blerje lëndësh djegëse për ngrohje (Pellet)*”, me fond limit 7 920 000 (shtate milion e nentëqind e njetzet mijë) lek pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 01.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh.

II.2. Në datën 23.02.2021, operatori ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon: [...]

- Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, është kërkuar: Leje mjedisore e tipit C Kodi III.1.A “*Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore. Subjekti jonë gjykon se ky kriter është i ekzagjeruar dhe nuk është në përputhje me LPP, RPP dhe objektin e prokurimit. Në rastin e procedurës objekt ankese, kemi të bëjmë me blerje lëndësh djegëse pellet për ngrohje. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të furnizojë spitalin Gramsh me lëndë djegëse për ngrohje pellet, dhe ky kriter i vendosur nga ana juaj nuk është në*

përputhje me objektin e prokurimit. Operatori ekonomik duhet vetëm të ketë kapacitete ligjore dhe teknike që të furnizojë spitalin Gramsh me lëndë djegëse për ngrohje pellet dhe në këtë rast, nuk është e nevojshme që të disponojë leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, pasi kjo leje mjedisore është e nevojshme vetëm për prodhuesit e lëndës djegëse pellet për ngrohje. Autoriteti kontraktor duhet të kërkonte leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, vetëm në rastin kur operatori ekonomik paraqet “kontratë me furnizuesin”, siç keni kërkuar juve te pika 2.3 kapaciteti teknik, pika “D” (faqe 29 e DST). Pra ju keni dubluar kriteret për kualifikim, pasi kërkon “Leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, dhe gjithashtu kërkon edhe “kontratë me furnizuesin”. Kërkesa e AK për Leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, do të ishte ligjore në rast se procedura e prokurimit do të ishte “punë” apo “shërbime” siç përcaktohet në nenin 26 dhe 27 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi vetëm për kontratat e punëve dhe shërbimeve mund të kërkonin këtë kriter. Ndërsa për kontratat e mallrave, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë certifikatat, dëshmi për rezultatin e mallit, vetëm për “mallrat” objekt prokurimi, dhe nuk mund të kërkon për operatorin ekonomik që do të kryejë furnizimin me mallin pellet për ngrohje. Përfundimisht kërkojmë heqjen e kriterit të vendosur në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Leje mjedisi tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”.

- Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, është kërkuar: Deklaratë e konformitetit sipas Direktivave Evropiane në nivel CE nga prodhuesi i kaldajave ose certifikatë Konformiteti për kaldajën përkatëse e lëshuar nga shoqëri të licencuara të akredituara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
AK ka kërkuar “deklaratë konformiteti” për kaldajën, pa specifikuar se çfarë lloj kaldaje, me çfarë të dhënash teknike. Madje juve nuk keni kërkuar as dokumentacion provues për kaldajat që janë faturë tatimore shitje ose deklaratë doganore për kaldajat, si të vetmet dokumente provuese të pronarit. Përfundimisht kërkojmë heqjen e këtij kriteri.
- Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, AK ka kërkuar:
A) Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatorin ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2020 dhe 2021 deri në datën e zhvillimit të procedurës.
Më pas, me shkresën e AK nr. 126/7prot., datë 01.03.2021 me lëndë “Kthim përgjigjeje ankesë” AK shprehet se ky kriter është modifikuar: Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatorin ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar në momentin e zhvillimit të procedurës.
Ky kriter i vendosur nga ana juaj është shumë i ekzagjeruar dhe i pambështetur në LPP dhe RPP. Ndërsa ky numër punonjësish vendoset nga AK vetëm për kontratat e punëve dhe shërbimeve. Është totalisht i paligjshëm vendosja e kriterit “jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2020 dhe 2021 deri në datën e zhvillimit të procedurës”.

Vendosja e kriterëve duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e procedurës së prokurimit, dhe kërkesa juaj për kualifikim për 10 persona të siguruar në momentin e zhvillimit të procedurës është totalisht e paligjshme. Përfundimisht kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

- Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar:
 - Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht:
 - Shofer-minimalisht 2 (dy). (1 (një) shofer me CAP certifikatën e aftësisë profesionale dhe 1 (një) shofer me DAP dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinave të rënda. Të paraqiten dokumentet që tregojnë se personi është i kualifikuar si shofer CAP dhe personi tjetër si shofer DAP si dhe listëpagesa ku figuron gjithsecili.
 - Punëtorë ngarkim-shkarkimi minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron).
 - Mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës)-minimalisht 1. (të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesa ku figuron).

Siç shpjeguar edhe më sipër, vendosja e këtij lloji kriteri (2 shoferë në listëpagesa...) është e paligjshme, dhe në kundërshtim me RPP, nenin 27 “kontrata e mallrave”. Operatori ekonomik për të siguruar furnizimin e spitalit me pellet, mund të ketë kontratë shërbimi me një shoqëri apo person fizik i licensuar për të kryer shërbim transporti, dhe në këtë rast nuk është e nevojshme që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë 2 shoferë në listëpagesë. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë në kriteret kualifikuese që operatori të paraqesë një kontratë shërbimi me një shoqëri ose person fizik të licensuar për transport mallrash. Gjithashtu, edhe vendosja e kriterit: 1 (një) shofer me CAP (certifikatë e aftësisë profesionale) dhe 1(një) shofer me DAP është e paligjshme, pasi mjafton vetëm patenta e shoferit të kamionit, për të kryer transportin e mallrave dhe vendosja e kriterëve të tjera është rënduese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Kërkesa e AK për kualifikim: - punëtorë ngarkim-shkarkimi minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron) është totalisht e paligjshme. Se me çfarë punëtorësh apo me çfarë mënyre do të shkarkohet lënda djegëse pellet pranë institucionit tuaj, është përgjegjësi e operatorit ekonomik, dhe vendosja e këtij kriteri nga ana juaj nuk është në përputhje me nenin 27 “kontratë e mallrave” të VKM.

Gjithashtu, vendosja e kriterit: -mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës)-minimalisht 1 (të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesë ku figuron) është totalisht e paligjshme. Operatori ekonomik për të siguruar mirëmbajtjen e kaldajave me pellet, mund të ketë kontratë shërbimi me një shoqëri ose person fizik i licensuar për të kryer këtë shërbim, dhe në këtë rast nuk është e nevojshme që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë 1 mekanik në listëpagesë. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë në kriteret kualifikuese që operatori të paraqesë një kontratë shërbimi e një shoqëri apo person fizik të licensuar për këtë shërbim për mirëmbajtjen e kaldajave. Kërkojmë heqjen e këtyre kriterëve për kualifikim të mësipërme dhe modifikimin e tyre sipas kërkesës tonë të shpjeguar më lart.

- Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar: operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 makinë transporti vetëshkarkuese me vinç me kapacitet mbartës minimalisht 6-10 ton (kjo nisur nga konsumi ditor i llogaritur rreth 660kg/ditë dhe kapacitet të depozitimit pranë Spitalit i llogaritur rreth 10 ton, çka do t'i jepte palëve kohë të mjaftueshme për furnizimet e njëpasnjëshme). Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjetet mbi 3.5 ton si dhe certifikata e transportit e vlefshme. Kërkesa e AK për këtë dokumentacion shoqërues të mjetit është e ekzagjeruar, për kërkesën për “tahograf” dhe “certifikatë transporti”, është e pakuptimtë kërkesa e AK për këto dokumente shoqëruese të mjetit dhe mjaftonte vetë “leje dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri për kualifikim.
- Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar:
 - Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës Bashki/ Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes për vitin 2020 ose kontratë furnizimi me subjekte private të shoqëruar me dokumentacionin e mësipërm (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe faturë tatimore shitjet Bashki/ Koncesionar) si dhe faturën tatimore të blerjes.
 - Nëse ofertuesit janë importues të lëndës drusore nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore për vitet 2019-2020. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontratë furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me faturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë që të garantohet realizimi me sukses i kontratës.
 - Deklaratë e operatorit ekonomik për disponimin e mallit gjendje minimum 25 % e sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë.

Këto kërkesa për kualifikim të vendosura nga ana juaj janë të paligjshme dhe të ekzagjeruara, pasi është mëse e mjaftueshme kërkesa juaj e vendosur për kualifikim:

C) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën e mallit,

Kontratën me furnizuesin,
Faturat e blerjes së malli,
Katalogë prodhimi,
Skedë teknike,
Linjë prodhimi pelleti.

Kërkesat për kualifikim duhet të vendosen që të jenë në përputhje me natyrën dhe llojin e procedurës dhe të objektit të tenderit. Është e pakuptimtë që AK të kërkojë “lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes ...”etj. Kur çdo operator ekonomik që do kryejë furnizimin e Spitalit Gramsh me lëndë djegëse pellet ka një kontratë furnizimi me një shoqëri të licencuar për prodhim pelleti e cila plotëson karakteristikat teknike të mallit të kërkuara nga ana juaj.... Është e ekzagjeruar dhe tendencioze kërkesa juaj për “gjendje minimum 25% e

sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë”. Operatori ekonomik mban përgjegjësi mbas lidhjes së kontratës për furnizimin e pellet për spitalin Gramsh dhe nuk është e nevojshme që të ketë këtë sasi malli në gjendje. Ky lloj kriteri lë shkak për abuzime dhe subjektivizma nga ana e AK... kërkojmë heqjen e këtij kriteri. Përfundimisht, i kërkojmë KPP që : të pranojë kërkesën tonë për të gjitha pikat për ndryshimin e kriterëve të kualifikimit që kemi paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP. [...]

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, me anë të shkresës me nr.126/7 Prot., datë 01.02.2021, duke e pranuar pjesërisht atë. Nga verifikimet në SPE autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

Shtojcë: **Njoftim**

Modifikim i dokumenteve standarde të tenderit me objekt:

“Blerje pellet briket për ngrohje”

REF-87046-02-15-2021

Në zbatim të Ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin publik “, i ndryshuar neni 42/2 , si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 , date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 62, njoftojmë operatorët ekonomikë se do të ndryshohen dokumentet standarde të tenderit me objekt ***“Blerje pellet briket për ngrohje ”***

Arsyeja e modifikimit të këtyre dokumenteve është për shkak të Rekomandimit të APP-së.

Njoftim

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me Nr. 25366 Prot., dhe Nr.8480 Prot., datë 30.12.2020, AK informon operatorët ekonomikë që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softuerike".

Për sa i përket kriterëve të parashikuara në Dokumentet Standarde të Tenderit bëjmë ndryshimin si më poshtë:

Në Shtojcën 8 pika 2 : Kriteret e Veçanta të Kualifikimit bëhen ndryshimet:

Pika 2.1. ishte

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Certifikatë: Sistemi menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (**OHSAS-18001**), ose ekuivalenti i tij/saj.

Pika 2.1. bëhet :

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë

- Certifikatën **OHSAS 18001**, mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose certifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare **ISO 45001-2018**.

Sqarim: Konsultohuni në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve.

Pika 2.1. ishte

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Leje mjedisore e tipit C Kodi III. 1.A “Shfrytëzim , përpunim dhe tregtim të lëndës drusore.

Pika 2.1. bëhet :

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë

- **Hiqe kërkesa për leje mjedisore të tipi C, ose leje me kod III.1.A, sipas ligjit Nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar”, ky tip lejeje është shfuqizuar.** Sqarim: Nenin 11, të Ligjit Nr. 52/2020, ku përcaktohet se: “Pas hyrjes në fuqi të ligjit, çdo parashikim për lejet e mjedisit të tipit C në ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen”.

Pika 2.3. ishte:

2.3.. Për kapacitetin teknik:

- Numrin e punonjësve të siguar lëshuar nga Administrata Tatimore për Operatorin Ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguar për vitin 2020 dhe 2021 deri më datën e zhvillimit të procedurës.

Pika 2.3. bëhet:

2.3. Për kapacitetin teknik:

- Numrin e punonjësve të siguar lëshuar nga Administrata Tatimore për Operatorin Ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguar, të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë (kontratat individuale të punës), si dhe të figurojnë në listëpagesa në përputhje me legjislacionin përkatës në datën e zhvillimit të procedurës.

Gjithashtu referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me kriteret e kualifikimit, sqarohet si vijon: Ndërsa kriteret e mëposhtme janë hartuar në përputhje me arsyetimin e vendimit të KPP 03/2021 datë 07.01.2021 (pra kanë kaluar në sitën e KPP).

G)Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht:

-Shofer-minimalisht 2 (dy). (1 (një) shofer me CAP certifikatën e aftësisë profesionale dhe 1 (një) shofer me DAP dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinave të rënda.

Të paraqiten dokumentet që tregojnë se personi është i kualifikuar si shofer CAP dhe personi tjetër si shofer DAP si dhe listëpagesa ku figuron gjithsecili.

-Punëtorë ngarkim-shkarkim- minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron).

-Mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës)-minimalisht 1.(të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesa ku figuron).

D)Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 makinë transporti vetëshkarkuese me vinç me kapacitet mbartës minimalisht 6 - 10 ton (kjo nisur nga konsumi ditor i llogaritur rreth 660 kg/ditë dhe kapacitetit të depozitimit pranë Spitalit i llogaritur rreth 10 ton, çka do ti jepte palëve kohe të mjaftueshme për furnizimet e njëpasnjëshme).

Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjetet mbi 3.5 ton si edhe certifikata e transportit e vlefshme.

Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati dhe objekti i kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjete mbi 3.5 ton dhe certifikata e transportit e vlefshme.

Për mjetet të paraqiten fotot përkatëse për identifikimin e mjetit.

D)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën e mallit,

*Kontratën me furnizuesin,
Faturat e blerjes së mallit,
Katalogë prodhimi,
Skedë teknike,
Linjë prodhimi pelleti.*

- Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës Bashki/ Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes për vitin 2020 ose kontratë furnizimi me subjekte private të shoqëruar me dokumentacionin e mësipërm (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe faturë tatimore shitjet Bashki/ Koncesionar) si dhe faturën tatimore të blerjes.*
- Nëse ofertuesit janë importues të lëndës drusore nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore për vitet 2019-2020. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontratë furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me faturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës.*
- Deklarate e operatorit ekonomik për disponimin e mallit gjendje minimum 25 % e sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë.*

E)Të ketë në pronësi ose kontratë qiraje (me afat që të përfshijë afatin e marrvëshjes kuadër) 2 kaldaja me të dhënat e përcaktuara në rubrikën Specifikimet Teknike.

Më sipër është shprehur qartë dhe nuk kemi çfarë arsytimi tjetër t'ju japim si ankues. Për rrjedhojë, nisur nga rrethanat e mësipërme, AK ka marrë parasysh pjesërisht këtë ankesë.

II.4. Në datën 04.03.2021 pala ankimuese “Nafire Molloholli” PF, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 196/2 Prot., datë 16.03.2021 protokolluar me tonën me nr.388/2 prot datë 23.03.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: [...] Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, është kërkuar: *Leje mjedisore e tipit C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore. Subjekti jonë gjykon se ky kriter është i ekzagjeruar dhe nuk është në përputhje me LPP, RPP dhe objektin e prokurimit. Në rastin e procedurës objekt ankesë, kemi të bëjmë me blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të furnizojë Spitalin Gramsh me lëndë djegëse për ngrohje pellet, dhe ky kriter i vendosur nga ana juaj nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Operatori ekonomik duhet vetëm të ketë kapacitete ligjore dhe teknike që të furnizojë Spitalin Gramsh me lëndë djegëse për ngrohje pellet, dhe në këtë rast, nuk është e nevojshme që të disponojë leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, pasi kjo leje mjedisore është e nevojshme vetëm për prodhuesit e lëndës djegëse pellet për ngrohje. Autoriteti kontraktor duhej të kërkonte leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, vetëm në rastin kur operatori ekonomik paraqet “kontratë me furnizuesin”, siç keni kërkuar juve te pika 2.3 kapaciteti teknik, pika “D” (faqe 29 e dst). Pra ju keni dubluar kriteret për kualifikim, pasi kërkonti “Leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, dhe gjithashtu kërkonti edhe “kontratë me furnizuesin”. Kërkesa e AK për Leje mjedisore tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, do të ishte ligjore në rast se procedura e prokurimit do të ishte “punë” apo “shërbime” siç përcaktohet në nenin 26 dhe 27 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi vetëm për kontratat e punëve dhe shërbimeve mund të kërkonti këtë kriter. Ndërsa për kontratat e mallrave, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë certifikatat, dëshmi për rezultatin e mallit, vetëm për “mallrat” objekt prokurimi, dhe nuk mund të kërkonti për operatorin ekonomik që do të kryejë furnizimin me mallin pellet për ngrohje. Përfundimisht kërkojmë heqjen e kriterit të vendosur në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Leje mjedisi tipi C Kodi III.1.A “Shfrytëzim, përpunim dhe tregtim të lëndës drusore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, referuar edhe shkresës me nr.126/7 Prot., datë 01.02.2021 “Kthim përgjigjeje ankese” është pranuar nga autoriteti kontraktor dhe si përfundim nuk ka objekt ankimimi dhe është përmbushur interesi i ankimimit.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, është kërkuar: Deklaratë e konformitetit sipas Direktivave Evropiane në nivel CE nga prodhuesi i kaldajave ose certifikatë Konformiteti për kaldajën përkatëse e lëshuar nga shoqëri të licensuara të akredituara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

AK ka kërkuar “deklaratë konformiteti” për kaldajën, pa specifikuar se çfarë lloj kaldaje, me çfarë të dhënash teknike. Madje AK nuk ka kërkuar as dokumentacion provues për kaldajat që janë faturë tatimore shitjeje ose deklaratë doganore për kaldajat, si të vetmet dokumente provuese të pronarit. Përfundimisht kërkojmë heqjen e këtij kriteri [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: Deklaratë e Konformitetit sipas Direktivave Evropiane në Nivel CE nga prodhuesi i kaldajave ose certifikatë Konformiteti për kaldajën përkatëse e lëshuar nga shoqëri të licensuara të akredituara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

(Ligji Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”).

Neni 3, pika 22 “Certifikatë konformiteti” është dokumenti i lëshuar nga organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, i cili pasqyron rezultatet e inspektimit teknik të pajisjes/instalimit nën presion, lidhur me plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë.

Neni 6, pika 1 Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit “CE”, të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse). Certifikata duhet të jetë e vlefshme.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit”.

III.2.3. Në nenin 30 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.2.4. Neni 1 i LPP parashikon shprehimisht se “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në respektim të dispozitës në fjalë, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që ofertuesit të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin/heqjen e kriterit të veçantë të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm lidhur me paraqitjen e certifikatës së konformitetit për pajisjet “kaldaja”, është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit. Komisioni gjykon se në rastin konkret rezulton se ky kriter nuk është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës (blerje pelleti), e si rezultat ndikon në kufizimin e konkurrencës dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi dhe bie në kundërshtim me nenin 1, pika 2 e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteri për paraqitjen e deklaratës së konformitetit EC/Certifikatë, nuk është

proporcional me objektin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi (blerje pelleti) dhe autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë kriter.

-Në lidhje me pretendimin e ankimuesit që AK ka kërkuar “deklaratë konformiteti” për kaldajën, pa specifikuar se çfarë lloj kaldaje, me çfarë të dhënash teknike, Komisioni sqaron se, autoriteti kontraktor në lidhje me specifikimet teknike të pajisjeve “kaldaja”, është shprehur në shtojcën nr.9 të dokumenteve të procedurës së prokurimit, ku ka përcaktuar specifikimet teknike të sistemit të ngrohjes për 2 (dy) kaldajat.

- Në lidhje me pretendimin e ankimuesit që AK nuk ka kërkuar as dokumentacion provues për kaldajat që janë faturë tatimore shitjeje ose deklaratë doganore për kaldajat, si të vetmet dokumente provuese të pronarit, Komisioni sqaron se, për sa i përket mënyrës së disponimit të tyre nga ana e operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktor ka përcaktuar dokumentacion konkret sipas pikës 2.3.E.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, AK ka kërkuar:

A)Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatorin ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2020 dhe 2021 deri në datën e zhvillimit të procedurës.

Më pas, me shkresën e AK nr.126/7 Prot., datë 01.03.2021 me lëndë “Kthim përgjigjeje ankese”AK shprehet se ky kriter është modifikuar: Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatorin ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar në momentin e zhvillimit të procedurës.

Ky kriter i vendosur nga ana juaj është shumë i ekzagjeruar dhe i pambështetur në LPP dhe RPP. Ndërsa ky numër punonjësish vendoset nga AK vetëm për kontratat e punëve dhe shërbimeve. Është totalisht i paligjshëm vendosja e kriterit “jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2020 dhe 2021 deri në datën e zhvillimit të procedurës”. Vendosja e kriterëve duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e procedurës së prokurimit, dhe kërkesa juaj për kualifikim për 10 persona të siguruar në momentin zhvillimit të procedurës është totalisht e paligjshme. Përfundimisht kërkojmë heqjen e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e procedurës së prokurimit, pika 2.3.A, “Për kapacitetin teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar këtë kriter: “Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2020 dhe 2021 deri në datën e zhvillimit të procedurës”.

III.3.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pretendim të ankimuesit argumentohet si vijon: “[...]me shkresën e AK nr. 126/7prot., datë 01.03.2021 me lëndë “Kthim përgjigjeje ankese” AK shprehet se ky kriter është modifikuar: Numrin e punonjësve të siguruar, lëshuar nga Administrata Tatimore për operatorin ekonomik duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjetë)

persona të punësuar, të siguruar, të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë (kontratat individuale të punës), si dhe të figurojnë në listëpagesa në përputhje me legjislacionin përkatës në datën e zhvillimit të procedurës. [...].”

III.3.3. Nga verifikimi në SPE rezulton se është publikuar shtojca për modifikim, në dokumentet e tenderit, shtojca datës 19.02.2021, pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, autoriteti kontraktor ka ndryshuar këtë kriter në: *“Numrin e punonjësve të siguruar lëshuar nga Administrata Tatimore për operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar, të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë (kontratat individuale të punës), si dhe të figurojnë në listëpagesa në përputhje me legjislacionin përkatës në datën e zhvillimit të procedurës”.*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit..”*

III.3.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 27 “Kontratat e Mallrave” pika 3 përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Edhe pas modifikimit të këtij kriteri, autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Nafire Molloholli” PF, lidhur me numrin e punonjësve të siguruar, që duhet të disponojë ofertuesit pjesëmarrës në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në objektin e prokurimit të kësaj procedure prokurimi, si dhe volumit të kontratës, gjykon, se kërkesa për këtë kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar të siguruar, të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi, e si rrjedhim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën për numrin e punonjësve në përputhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, duke përcaktuar një numër të nevojshëm në proporcion me volumin e kontratës, për realizimin me sukses të saj.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar: -Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht:

-Shofer-minimalisht 2 (dy). (1 (një) shofer me CAP certifikatë e aftësisë profesionale dhe 1 (një) shofer me DAP dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinave të rënda. Të paraqiten dokumentet që tregojnë se personi është i kualifikuar si shofer CAP dhe personi tjetër si shofer DAP si dhe listëpagesa ku figuron gjithsecili.

-Punëtorë ngarkim-shkarkim- minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron).

-Mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës)-minimalisht 1. (të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesa ku figuron). Siç shpjeguar edhe më sipër, vendosja e këtij lloji kriteri (2 shofera në listëpagesa...) është e paligjshme, dhe në kundërshtim me RPP, nenin 27 “kontrata e mallrave”. Operatori ekonomik për të siguruar furnizimin e spitalit me pellet, mund të ketë kontratë shërbimi me një shoqëri apo person fizik i licensuar për të kryer shërbim transporti, dhe në këtë rast nuk është e nevojshme që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë 2 shoferë në listëpagesë. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë në kriteret kualifikuese që operatori të paraqesë një kontratë shërbimi me një shoqëri ose person fizik të licensuar për transport mallrash. Gjithashtu, edhe vendosja e kriterit: 1 (një) shofer me CAP (certifikatë e aftësisë profesionale) dhe 1(një) shofer me DAP është e paligjshme, pasi mjafton vetëm patenta e shoferit të kamionit, për të kryer transportin e mallrave dhe vendosja e kriterëve të tjera është rënduese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Kërkesa e AK për kualifikim: - punëtorë ngarkim-shkarkim – minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron) është totalisht e paligjshme. Se me çfarë punëtorësh apo me çfarë mënyre do të shkarkohet lënda djegëse pellet pranë institucionit tuaj, është përgjegjësi e operatorit ekonomik, dhe vendosja e këtij kriteri nga ana juaj nuk është në përputhje me nenin 27 “kontratë e mallrave” të VKM. Gjithashtu, vendosja e kriterit: -mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës)-minimalisht 1 (të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesa ku figuron) është totalisht e paligjshme. Operatori ekonomik për të siguruar

mirëmbajtjen e kaldajave me pellet, mund të ketë kontratë shërbimi me një shoqëri ose person fizik i licensuar për të kryer këtë shërbim dhe në këtë rast nuk është e nevojshme që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë 1 mekanik në listëpagesë. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë në kriteret kualifikuese që operatori të paraqesë një kontratë shërbimi e një shoqëri apo person fizik të licensuar për këtë shërbim për mirëmbajtjen e kaldajave. Kërkojmë heqjen e këtyre kriterëve për kualifikim të mësipërme dhe modifikimin e tyre sipas kërkesës tonë të shpjeguar më lart”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1 Në pikën 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht:*

*-Shofer – minimalisht 2(dy) (1(një) shofer me CAP, **certifikatë e aftësisë profesionale** dhe 1(një) -shofer me DAP, **dëshmi e aftësisë profesionale**, për përdoruesit e makinave të rënda”*

Të paraqitën dokumentet që tregojnë se personi është i kualifikuar si shofer CAP dhe personi tjetër si shofer DAP si dhe listëpagesa ku figuron gjithsecili.

-Punëtorë ngarkim shkarkimi – minimalisht 4 (2 për çdo shofer listëpagesa ku figuron).

-Mekanik i kualifikuar për mirëmbajtjen e kaldajave (referuar objektit të kontratës) – minimalisht 1 (të paraqitet një dokument që tregon se personi është i kualifikuar si mekanik si dhe listëpagesa ku figuron).

III.4.2 Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.

III.4.2.1 Në pikën 1 të VKM nr.808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, i ndryshuar me VKM nr.736 datë 01.07.2009 parashikohet se: “Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me dëshmi aftësie”.

III.4.3 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët,

nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.4.4 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se përcaktimi i kriterit për disponimin e *1(një)-shofer me CAP, certifikatë e aftësisë profesionale dhe 1(një)-shofer me DAP, dëshmi e aftësisë profesionale, për përdoruesit e makinave të rënda*, është e ekzagjeruar dhe rëndon operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Komisioni sqaron, se referuar dhe dispozitave ligjore për qarkullimin e mjeteve në rrugë, pajisja e shoferit me dëshmi të aftësisë profesionale (DAP) jepet vetëm për përdoruesit e mjeteve të rënda të ndërtimit të kategorizuara sipas grupeve Manovratorë për Eskavatorisë, Buldozeristë dhe Automakinistë. Ndërsa, certifikata e aftësisë profesionale (CAP) është një dokument që vërteton aftësimin profesional të përdoruesve të mjeteve rrugore që drejtohen me leje drejtimi të kategorive C, CE, D(*) dhe DE, modeli i të cilës, është pjesë e Udhëzimit Nr.3606/2, datë 28.10.2011, është i njëjtë me ato që parashikon direktiva e BE-së 2003/59/KE. Udhëzimet për pajisjen me certifikatë të aftësisë profesionale (CAP) janë të përcaktuara në Udhëzimin Nr.3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D dhe DE, me Certifikatën e Aftësimit Profesional”, të ndryshuar, dhe Rregullores së DPSHTRR-së, Nr .7, datë 11/12/2015, “Për administrimin e aktivitetit të kualifikimit dhe testimit të kandidatëve që do të pajisen me Certifikatën e Aftësimit Profesional (CAP), e cila lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Në rastin konkret, kërkesa e disponimit të shoferëve me *certifikatë e aftësisë profesionale (CAP) dhe me dëshmi e aftësisë profesionale (DAP)*, nuk i shërben autoritetit kontraktor për të njohur kapacitetet profesionale të ofertuesve, por e rëndon pozitën e tyre. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marri masa për modifikimin e këtij kriteri duke iu referuar dispozitave ligjore të transportit rrugor të mjeteve në bazë të kërkesës së disponimit të shoferit në përputhje me mjetin e kërkuar, për të realizuar transportin e mallit që do të prokurohet.

Gjithashtu, Komisioni gjykon se, kërkesa e AK në lidhje me kriterin për paraqitjen e minimumi të 4 punëtorëve ngarkim-shkarkim nuk është në proporcion me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë mall, çka do të thotë që jemi përpara një kontrate furnizimi malli, e cila referuar specifikimeve teknike nuk ka element furnizim/vendosje që të justifikojë vendosjen e kapaciteteve të punëtorisë *minimumi 4* sikundër është vendosur në rastin konkret. Komisioni gjykon se, kjo është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk i shërben AK për të njohur kapacitetet teknike për sigurimin e mallit sipas specifikimeve teknike të vendosura në dokumentet e tenderit dhe AK duhet të përcaktojë një numër të nevojshëm në proporcion me volumin e kontratës, për realizimin me sukses të saj.

Lidhur me kriterin për disponimin e një mekaniku për mirëmbajtjen e kaldajave, KPP gjykon se, kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor për kontratën objekt prokurimi nuk është në përputhje me

natyrën e kontratës. Në rastin konkret, jemi para një kontrate që ka për objekt vetëm furnizimin me mallra (pellet) dhe autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar shërbim të mirëmbajtjes së sistemit ngrohës të kaldajave. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë kriter.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“[...]Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar: operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 makinë transporti vetëshkarkuese me vinç me kapacitet mbartës minimalisht 6-10 ton (kjo nisur nga konsumi ditor i llogaritur rreth 660kg/ditë dhe kapacitet të depozitimit pranë Spitalit i llogaritur rreth 10 ton, çka do t'i jepte palëve kohë të mjaftueshme për furnizimet e njëpasnjëshme). Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjetet mbi 3.5 ton si dhe certifikata e transportit e vlefshme. Kërkesa e AK për këtë dokumentacion shoqërues të mjetit është e ekzagjeruar, për kërkesën për “tahograf” dhe “certifikatë transporti”, është e pakuptimtë kërkesa e AK për këto dokumente shoqëruese të mjetit dhe mjaftonte vetëm “leja dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri për kualifikim, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1 Në pikën 2.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 makinë transporti vetëshkarkuese me vinç me kapacitet mbartës minimalisht 6 - 10 ton (kjo nisur nga konsumi ditor i llogaritur rreth 660 kg/ditë dhe kapacitetit të depozitimit pranë Spitalit i llogaritur rreth 10 ton, çka do ti jepte palëve kohë të mjaftueshme për furnizimet e njëpasnjëshme).

Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjetet mbi 3.5 ton si edhe certifikata e transportit e vlefshme.

Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati dhe objekti i kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, tahograf për mjete mbi 3.5 ton dhe certifikata e transportit e vlefshme.

Për mjetet të paraqiten fotot përkatëse për identifikimin e mjetit.

III.5.2 Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të*

tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*.

III.5.3 Në pikën 1 të nenin 177 të Kodit Rrugor të RSH (Ligji nr.8378 datë 22.07.1998) parashikohet se: *“Mjetet duhet të qarkullojnë të pajisura me tahograf, me karakteristikat, rastet dhe mënyrat e përdorimit të përcaktuara në aktet në zbatim”*.

Ndërsa, në pikën 1, të nenin 343 të VKM nr.153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Të gjitha mjetet e treguara në nenin 54 të Kodit Rrugor me peshe maksimale bruto mbi 3500 kg duhet, detyrimisht, të pajisen me tahograf, sipas nenit 177, pika 1, të Kodit Rrugor”*.

III.5.4 Në nenin 30 të Udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” parashikohet se: *“Veprimtaria e transportit të mallrave për llogari të vet brenda vendit, ushtrohet kundrejt certifikatës. Kjo certifikatë lëshohet për subjekte fizike ose juridike”*.

III.5.5 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.5.6 Sipas dispozitave ligjore të sipërcituara për mjetet e transportit me peshë mbi 3500 kg, funksioni i të cilëve është transporti i mallrave, kanë detyrim ligjor të pajisen me tahograf si dhe certifikatë transporti. Komisioni vëren se, ankimesi ka kërkuar modifikim të kriterit lidhur me mjetet në pronësi, kërkesën për “tahograf” dhe “certifikatë transporti”, pasi është e ekzagjeruar. Referuar dispozitave ligjore për sa i përket qarkullimit të mjeteve në rrugë, KPP gjykon se, AK ka përcaktuar saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në lidhje me kërkesën për “tahograf” dhe “certifikatë transporti” për mjetet në pronësi, pasi është detyrim ligjor disponimi i tyre për mjetet e transportit të mallrave.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...]Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik, juve keni kërkuar:

- Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me **lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes** për vitin 2020 ose kontratë furnizimi me subjekte private të shoqëruar me dokumentacionin e mësipërm (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe faturë tatimore shitjet Bashki/Koncesionar) si dhe faturën tatimore të blerjes.
- Nëse ofertuesit janë importues të lëndës drusore nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore për vitet 2019-2020. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontratë furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me faturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës.
- **Deklaratë e operatorit ekonomik për disponimin e mallit** gjendje minimum 25 % e sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë.

Këto kërkesa për kualifikim të vendosura nga ana juaj janë të paligjshme dhe të ekzagjeruara, pasi është mëse e mjaftueshme kërkesa juaj e vendosur për kualifikim: C) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën e mallit,

Kontratën me furnizuesin,
Faturat e blerjes së mallit,
Katalogë prodhimi,
Skedë teknike,
Linjë prodhimi pelleti.

Kërkesat për kualifikim duhet të vendosen që të jenë në përputhje me natyrën dhe llojin e procedurës dhe të objektit të tenderit. Është e pakuptimtë që AK të kërkojë “lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes ...” etj....Kur çdo operator ekonomik që do kryejë furnizimin e Spitalit Gramsh me lëndë djegëse pellet ka një kontratë furnizimi me një shoqëri të licencuar për prodhim pelleti, e cila plotëson karakteristikat teknike të mallit të kërkuar nga ana juaj.... Është e ekzagjeruar dhe tendencioze kërkesa juaj për “gjendje minimum 25% e sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë”. Operatori ekonomik mban përgjegjësi mbas lidhjes së kontratës për furnizimin e pellet për spitalin Gramsh dhe nuk është e nevojshme që të ketë këtë sasi malli në gjendje. Ky lloj kriteri lë shkak për abuzime dhe subjektivizma nga ana e AK... kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

III.6.1 Në pikën 2.1 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën e mallit,

Kontratën me furnizuesin,
Faturat e blerjes së mallit,

*Katalogë prodhimi,
Skedë teknike,
Linjë prodhimi pelleti.*

- *Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes për vitin 2020 ose kontratë furnizimi me subjekte private të shoqëruar me dokumentacionin e mësipërm (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe faturë tatimore shitjet Bashki/Koncesionar) si dhe faturën tatimore të blerjes.*
- *Nëse ofertuesit janë importues të lëndës drusore nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore për vitet 2019-2020. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontratë furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me faturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës.*
- *Deklaratë e operatorit ekonomik për disponimin e mallit gjendje minimum 25 % e sasisë së prokuruar. AK rezervon të drejtën e verifikimit të mallit gjendje në magazinë”.*

III.6.2 Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.*

III.6.3 Në pikën 2, të nenit 26 të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” parashikohet: *“Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar vetëm me lejen përkatëse, të lëshuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Kushtet dhe kriteret për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fondin pyjor kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Të drejtat, që sigurohen nga leja e ushtrimit të veprimtarisë në fondin pyjor kombëtar, nuk mund t'u transferohen apo t'u jepen të tretëve. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në pyje e kullota, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike të miratuara”.*

III.6.4 Sipas dispozitës së Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, organet e shërbimit pyjor, para dhënies së lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor publik, bashkërendojnë punën me strukturat e Ministrisë së Mjedisit dhe të Ministrisë së Industrisë dhe

Energjetikës, të cilat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kanë të drejtë të pajisin subjektet fizike e juridike me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarive në fushën e tyre. Pra, prodhuesit e mallit objekt prokurimi, të cilët shfrytëzojnë me veprimtarinë e tyre sipas skemave teknologjike të miratuara fondin pyjor, referuar lejes së shfrytëzimit të pyllit të miratuar. Komisioni gjykon se, kriteri për paraqitjen e kontratës së furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes për vitin 2020 ose kontratë furnizimi me subjekte private të shoqëruar me dokumentacionin e sipërcituar, është një kriter i ekzagjeruar, pasi leja e shfrytëzimit të pyllit i adresohet palëve të treta, të cilat nuk janë pjesë e procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit që është blerje malli (pellet), është e nevojshme kontrata e furnizimit me lëndë drusore nga subjekti shitës dhe jo shoqërimi i saj me lejen e shfrytëzimit të pyllit nga subjekti shitës /privat dhe faturën tatimore të shitjes, pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar edhe kritere të tjera për të vërtetuar origjinën e mallit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri dhe të heqë kërkesën për leje shfrytëzimi të pyllit nga subjekti shitës /privat dhe faturën tatimore të shitjes.

-Në lidhje me “Deklaratë e operatorit ekonomik për disponimin e mallit gjendje minimum 25 % e sasisë së prokuruar”, referuar edhe shtojcës nr.10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar 24 muaj nga lidhja e MK sipas kërkesës së saj. Pra, nuk ka përcaktuar sasinë konkrete dhe kohën e nevojshme se kur i duhet malli që do të prokurohet në spital dhe kërkesa e disponimit gjendje minimum 25% e sasisë së mallit përpara së të shpallet fitues operatori ekonomik pjesëmarrës është kriter i ekzagjeruar. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë kriter kualifikimi nga dokumentet e procedurës së prokurimit.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nafire Molloholli” PF për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr.REF-87046-02-15-2021, me objekt “Blerje lëndësh djegesë për ngrohje (Pellet) ”, me fond limit 7 920 000 (shtatë milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Nafire Molloholli” PF.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 388 Protokolli, Datë 04.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri